



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr.03, datë 23.07.2025

PËR

MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“RIKONSTRUKSIONI I GODINAVE TË MATERNITETIT "MBRETËRESHA
GERALDINË" DHE NDËRTIM I RI”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 40, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim zhvilluesit Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin e shtyrjes së afatit të Lejes së Ndërtimit të objektit: “Rikonstruksioni i godinave të maternitetit "Mbretëresha Geraldinë" dhe ndërtim i ri”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me zhvillues Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, miratuar me Vendimin Nr. 11, datë 03.12.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit.
2. Afati i kryerjes së punimeve sipas këtij Vendimi, do të pasqyrohet në Dokumentin e Lejes së Ndërtimit, në përputhje me afatin e përcaktuar në grafikun e punimeve.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyjnë në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDJ RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MROJTJES SOCIALE
ALBANA KOÇIU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 22/09/2025